



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE, MONITORIMIT TE INVESTIMEVE DHE
SHERBIMEVE

RELACION TEKNIK

Objekti : Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton te rruges Banaj

Investitor : Bashkia Patos

Vendodhja

Objekti në fjalë ndodhet ne lagjen Banaj, te qytetit te Patosit dhe eshte vazhdim i segmentit te rruges Cameria. Vendndodhja e objektit të investimit është në pjesën jugore të qytetit të Patosit. Rruga në fjalë lidh lagjen Banaj me qendrën e qytetit. Gjatesia e ketij segmenti eshte rreth 1550 ml.





Përshkrimi i situatës ekzistuese

Gjatë viteve janë bërë segmente të caktuara nëpër rrugët e lagjes Banaj, ndersa rruga që I vjen si unazë lagjes, ka mbetur e pa shtruar me asfaltobeton. Në lagjen Banaj banojnë banorë të vjetër të qytetit por në pjesën e sipërme të kësaj lagjeje keni ndërtimin e shumë shtëpive të reja të ndërtuara nga banorët e rinj të qytetit.

Rruga që propozojmë të ndertohej do të ketë një gjatësi prej 1.5 km dhe një gjerësi 3.5 ml. Për ndërtimin e saj janë parashikuar nënshtresat e rrugës me cakëll dhe stabilizant. Për pjesën e sipërme të rrugës është parashikuar ndërtimi i shtresave me binder dhe asfaltobeton. Për vetë kushtet e terrenit në të cilin shtrihet rruga është menduar në pjesën e parë të saj, e cila ka një fluks më të madh lëvizje të mjeteve dhe të këmbësorëve, ndërtimi i një trotuari për kalimin e këmbësorëve. Një element i veçantë i ndërtimit të rrugës është mbulimi I saj me ndricim në të gjithë gjatësinë e saj me ndricues LED më panele fotovoltaike.

Qellimi

Qellimi kryesor I investimit është përmirësimi I kushteve të jetesës së banorëve të kësaj lagjeje të qytetit dhe përdorimi I saj si një rrugë unazë për këto lagje. Me rikonstruksionin e rrugës synohet të kthehet me gjendje të mirë lëvizja e njerezve dhe mjeteve në këtë segment e cila është e demtuar nga kushtet atmosferike dhe mungesa e investimeve për një kohë të gjatë. Krijimi I kushteve me cilësore në jetesën e banorëve të kësaj lagjeje dhe krijimi I një rrugë lidhëse në formë unazë do të shërbejë me tej për sigurinë e banorëve dhe veçanërisht fëmijëve që shkojnë në shollë dhe përdorin këto rrugë. Gjithashtu me këtë investim në këto rrugë do të sigurohen kushte me të mira lëvizjeje përgjatë të gjithë vitit.

Përshkrimi I punimeve që do të kryhen

Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë këtë segment ku do të bëhet rikonstruksioni i plote i tij duke e pajisur me gjithë elementet e nevojshëm, konkretisht: Segmenti nga piketa 0-28 me një gjatësi totale rreth 280m e cila shtrihet në zone të banuar do të jetë i mobiluar me elemente si asfaltimi i karrexhates me gjerësi 3.5 m, kurbet b/a 40 cm në njërën kah dhe bankine granili 40 cm në kahun tjetër, trotuar vetëm nga njëri krah i segmentit, ndricim si edhe rehabilitimin e sistemit të kullës ekzistues duke e kthyer kështu në një segment sipas standarteve bashkohore, duke mundësuar në këtë mënyrë jo vetëm qarkullimin e lirshëm të automjeteve por edhe të banorëve të zonës duke minimizuar aksidentet e mundshme dhe duke përmirësuar mënyrën e jetesës së tyre. Ky segment i banuar do të pajiset gjithashtu me elementet përkatës të ndricimit, shtylla metalike konike ndricimi me lartësi 8 m të cilat do të mundësojnë aksesin e lehtë të banorëve dhe automjeteve gjatë natës.



Duke patur parasysh qellimin e ketij investimi, kemi menduar krijimin e lehtesirav ene levizjen e njezve dhe mjeteve drejt qendres se qytetit per banoret e kesaj lagjeje. Punimet do te kryhen si me poshte:

Punime prishjeje

Eshte parashikuar prishja e te gjitha nderhyrjeve ne trupin e rruges te bera nga banoret pergjate viteve. Gjithashtu do te prishen edhe shtresat e siperme te rruges ekzistuese dhe nderhyjst sporadike te bera nga banoret e zones perpara banesave te tyre.

Puime betoni e b/a

Ne keto punime eshte parshikuar ndertimi I mureve mbajtese b/a ne disa zona ku kalon rruga per shkak te shkarjeve te ndodhura ose per shkak te terrenit ekzistues. Keto mure mbajtese do te behen sipas detajit te dhene ne project. Ne projet eshte menduar edhe ndertimi I strehes mbi shkalet hyrese ne objekt.

Ndertimi I ketyre mureve synon stabilizimin e trupit te rruges dhe permiresimin e terrenit prane saj.

Punimet e shtresave

Ne punimet e shtresave kemi perfshire te gjitha shtresat dhe neshtresat e tyre per krijimin e struktures se qendrueshme te trupit te rruges. Nenshtresat e me cakell eshte per mbushjen e gropave ne rruge dhe krijimin enje shtrese baze per shtresat e tjera te rruges. Mbi kete shtrese eshte parashikuar nje shtrese stabilizanti me trashesi $t=10$ cm. mbi shtresen e stabilizanti , pas sperkatjes me 05kg/m^2 bitum do te shtrohet shtrea e binderit me trashesi $t=5\text{cm}$ dhe shtresa e asfaltobetonit me trashi $t= 4$ cm. ne te dyja anet e rruges do te behen bankinat me material guri te thyer (stabilizant) me trashi $t=10$ cm

Punime trotuari

Ne pjesen e pare te rruges do te behet trotuar me pllaka betony te parapergatitura me trashesi $t= 6\text{cm}$ te shtruara mbi nje shtrese rere. Konturimi I trotuarit do te behet me bordure betony te parapergatitura sipas permasave te dhena ne projet.

Per cdo ndryshim apo pamundesi ndeertimi sipas te dhenave te projektit duhet te njoftohet grupi projektimit.

Punoi:

ing. Arben Manoku

ing. Silana Mici